

## Transplantimi i pjesëve të trupit - II -

Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë Allahut, paqja dhe lavdërimi i Tij qofshin për të Dërguarin e Tij, familjen, shokët e tij, dhe të gjithë ata që ndjekin rrugën e tij. Më pas:

Si plotësim i pjesës së parë në këtë çështje, vlen të cekën disa dispozita shtesë që kanë të bëjnë me transplantimin, prej tyre:

### ***1- Transplantimi i organeve nga i vdekuri tek i gjalli.***

Fillimisht duhet ditur se sa i përket personit të vdekur, kemi të bëjmë me dy raste:

1) I sëmuri i cili është goditur me vdekje të trurit, e cila është: ndërprerja e përhershme e funksionit të trurit të njeriut, pa kthim prapa.

Po ashtu, i godituri me vdekje klinike.

Ky rast, dispozita e tij sipas shariatit është sikurse personi i gjallë, andaj gjykimi për të është sikurse te personi i gjallë, gjë që është sqaruar në pjesën e parë.

2) I vdekuri i cili është vërtetuar dalja e shpirtit dhe mbarimi i jetës së tij në mënyrë të sigurt.

***Gjykimi:*** Transplantimi nga i vdekuri, ka të njejtin gjykim sikurse tek i gjalli. Pra, të dy mendimet e cekura në pjesën e parë të kesaj teme ekzistojnë edhe këtu.

Duke shtuar se tek i vdekuri, sipas mendimit që e lejon një gjë të tillë, lejohet edhe transplantimi i pjesëve që shkaktojnë vdekje, apo paaftësi të ndonjë organi vital të tij, si: zemra, mëlçia, truri, etj., sepse tashmë ky njeri është i vdekur.

Gjithnjë duke u përmbajtur kushteve të përmendura, duke shtuar këtu:

Marrja leje paraprake nga vet personi sa ishte gjallë, ose konfirmimin e familjes së tij pas vdekjes, pra nuk lejohet vetëm se me lejen e tyre.

Këshilli Ndërkombëtar i Fikhut Islam, pas shqyrtimit të studimeve fikhere dhe mjekësore të bëra në këtë drejtim, në mbledhjen e tyre të mbajtur në Xhideh më 1408 h, ka vendosur se: "lejohet transplantimi i organeve, qoftë nga i gjalli, apo nga i vdekuri, sipas kushteve të lartcekura".

## ***2- Transplantimi nga kafsha te njeriu.***

Së pari, duhet ditur se kafshët sipas legjislacionit islam janë dy lloje:

1) *Të pastërta*; janë ato kafshë të cilat lejohet ngrënia e mishit të tyre.

**Gjykimi:** Lejohet transplantimi i organeve të këtyre kafshëve te njeriu, me kusht që të therret së pari sipas rregullave të sheriatit.

Nëse nuk therret, nuk lejohet përveçse në rast domosdoshmërie.

2) *Të ndyta*, janë ato kafshë të cilat nuk lejohet ngrënia e mishit të tyre.

**Gjykimi:** Nuk lejohet transplantimi i pjesëve nga këto kafshë, përveç në raste shumë të domosdoshme, si: frika nga shkatërrimi, apo humbja e ndonjë pjese trupore, atëherë në këto raste lejohet.

### ***3- Transplantimi i fabrikuar.***

Ketu hyjnë: organet e fabrikuara nga materiale të ndryshme plastike, qelqi, etj.

**Gjykimi:** Lejohet.

Për rastet e lartcekura shih: vendimin e Këshillit Ndërkombëtar të Fikhut, të mbajtur në Indi, më 1410 h.

Shih po ashtu librin: Fikhun Navazil të dr. Muhamed Xhejzani, vëll. 4.

#### ***4- Transplantimi nga embrioni, apo foshnja e abortuar te njeriu.***

***Gjykimi:*** Ka dy mendime në këtë çështje:

I pari: Nuk lejohet.

I dyti: Lejohet nëse është nevoja shpëtimi i jetës së ndonjë krijese të gjallë.

Me kusht që të mos abortohet qëllimisht, mirëpo të jetë abortim natyral, apo me ndonjë arsye shariatike.

Allahu e di më së miri.

#### ***Këshillë:***

Çdo kush që detyrohet ta marrë një hap të tillë drejt transplantimit, e këshillojmë që para se gjithash të konsultohet me dy persona:

I pari: Mjek specialist i besueshëm, ashtu që ta orientojë në opcionet e mundshme dhe efikase.

I dyti: Hoxhë i besueshëm që ka njohuri rreth dispozitave të kësaj çështjeje, ashtu që ta orientojë në atë që është e lejuar dhe ta largojë nga ajo që është e ndaluar.

Lus Allahun e Lartesar t'i shërojë të sëmurët e muslimanëve, dhe t'u jap atyre begati dhe mirëqenie.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

Pergatiti: Agron Krasniqi